



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo Rada i Socijalne Zastine - Ministry of Labour and Social Welfare

Prishtinë 27 Dhjetor 2019

**Thirrje publike për mbështetje financiare publike për projektet e OJQ-ve/
Strehimoreve të licencuara në fushën e shërbimeve sociale**

1. *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale* u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të regjistruara dhe licencuara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në mbështetjen e fëmijeve, viktimave të dhunës në familja dhe viktimave të trafikimit, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare.
2. OJQ-të/Strehimoret në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet e tyre për ofrimin e shërbimeve sociale.
3. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në ofrimin dhe avancimin e shërbimeve sociale përmes aktiviteteve si më poshtë:
 - 3.1 Shërbime rezidenciale dhe ditore për mbrojtjen e fëmijëve të abuzuar, keqtrajtuar dhe neglizhuar;
 - 3.2 Shërbime rezidenciale dhe ditore për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe viktimave të trafikimit;
 - 3.3 Shërbime rezidenciale dhe ditore për mbrojtjen e viktimave të trafikimit.
4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 500,000.00 euro. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 20,000.00 euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 55,000.00 euro.
5. Varësisht prej llojit të fushës dhe ofrimit të shërbimeve projekti mund të financohet deri në 100 % të totalit të kostove të pranueshme të projektit, por jo më pak se vlera minimale dhe maksimale për një projekt individual të përcaktuar në pikën nr.4 të kësaj thirrje dhe kritreve të përcaktura në Udhëzuesin për Aplikantët.

6. Aplikantët dhe partnerët potencialë, për pjesën tjetër të kostove mund të sigurojnë bashkëfinancim nga donatorët dhe burimet tjera publike apo burimet vetanake.

7. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë dhe përfundon me datën 20 Janar 2020.

8. OJQ-të mund të aplikojnë në më së shumti vetëm në një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje.

9. Periudha e zbatimit të projektit është për 10-12 muaj. OJQ mund të përfshihet me se shumti në një(1)projekt dhe të përfshihet në zbatimin e vetëm një (1) fushe prioritare.

10. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të/Strehimoret që janë të regjistruara dhe duhet të janë të licencuara nga MPMS-ja.

11. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në ndonjërin nga llojet e fushës dhe aktivitetet të përfshirë në kuadër të kësaj thirrje publike.

12. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale *ndaj ofruesit të mbështetjes financiare*.

13. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara.

14. Propozimet do të dorëzohen në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të *Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale*

15. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme:

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, pranë Hotel Grandit, Sheshi Miss Edit Durhan nr.46, Prishtinë, Zyra e Arkives në MPMS.

16. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në *Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike*.

17. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

18. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, tek z. Ylber Kokollari-Zyrtar për licencim në Departamentin e Politikave Sociale dhe Familjes, duke e kontaktuar përmes e-mailit në adresën; Ylber.Kokollari@rks-gov.net